

## STATUT DHE AKT THEMELIMI

### I SHOOËRISË “EVS Engineering” SH.P.K TIRANË

Në këtë Statut:

- “Ligji” është Ligji Nr. 9901, dt. 14.04.2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”, i ndryshuar;
- “Statuti” është Statuti i shoqërisë.

Për të bërë të mundur veprimtarinë ekonomike dhe organizimin e kësaj shoqërie në përputhje dhe në zbatim të Ligjit Nr. 9901, datë 14.04.2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”, i ndryshuar, është përpiluar ky Statut dhe Akt Themelimi për shoqërinë tregtare me përgjegjësi të kufizuar, rregulluar si më poshtë vijon.

#### **Kreu 1 – Shoqëria**

##### **Neni 1**

###### **Data e themelimit, Emri dhe Themeluesit**

- 1) Sot, më datë 10.10.2022, ne, themeluesit, kemi vendosur që me vullnetin tonë të lirë dhe të plotë të krijojmë një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, emërtuar “EVS Engineering” SH.P.K, e cila do të rregullohet në mbështetje të Ligjit Nr. 9901, datë 14.04.2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”, i ndryshuar, Ligjet Nr. 9723, datë 03.05.2007 “Për Qëndrën Kombëtare të Biznesit”, si dhe të legjislacionit shqiptar në fuqi dhe normave që vijojnë në këtë Statut dhe Akt Themelimi të Shoqërisë (“**Shoqëria**”).

Shoqëria me Përgjegjësi të Kufizuar e themeluar prej nesh është një subjekt juridik shqiptar, të cilit i lind e drejta të ushtrojë aktivitetin që nga data e regjistrimit në Qëndrën Kombëtare të Biznesit.

- 2) Ortakët themelues të kësaj shoqërie janë:

**Znj. Vanina Latifi**, e bija e Hasan-it dhe e Hurma-së, lindur në Gramsh, më 01.03.1992 e banuese në Rrugën “Saraçeve”, Nd. 53, H. 1, Tiranë, madhore, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, me kombësi e shtetësi shqiptare, mbajtës e letërnjoftimit biometrik me nr. personal J25301112S, dhe

**Z. Egis Buzi**, i biri i Agron-it dhe i Lejles, lindur në Tiranë, më 21.07.1990 e banues në Rrugën “Saraçeve”, Nd. 53, H. 1, Tiranë, madhor, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, me kombësi e shtetësi shqiptare, mbajtës i letërnjoftimit biometrik me nr. personal J00721069T.

së bashku referuar si “**Ortakët e Shoqërisë**” ose “**Ortakët themelues**”.

Shoqëria do të jetë e formës së shoqërisë tregtare me përgjegjësi të kufizuar dhe ne, ortakët e saj themelues zotohemë të përballojmë humjet deri në kufirin e vlerës të kontributit të derdhur në kapitalin themelor. Statuti dhe Akti i Themelimit janë aktet bazë ku do të mbështetet



themelimi i shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar "EVS Engineering" SH.P.K si dhe zhvillimi i metejshëm i veprimtarisë së saj.

## Neni 2

### Objekti

Objekti i aktivitetit ekonomik të shoqërisë do të jetë:

- 1) Projektim objektesh ekonomike, civile, industrial, bujqesore, ushtarake, urbanistike, infrastruktura, furnizim me uje- kolektore shkarkimi, ujeselles kanalizime urbanerurale, topografi, hidrogeologji, gjeologji dhe sinjalistike rrugore;
- 2) Sherbime Konsulenve Inxhinierike per projektim, zbatim veprash te te gjitha kategorive dhe drejtimin teknik te punimeve ne çdo lloj aktiviteti te lidhur me to;
- 3) Studimi dhe Përgatitja e Projekteve mbi Masat e Mbrojtjes nga Zjarrit të Ndërtesave te cdo lloji;
- 4) Mbikqyrje dhe kolaudim te punimeve te zbatimit sipas kategorive: Punime te pergjithshme ndertimi NP-1, NP-2, NP-3, NP-4, NP-5, NP-6, NP-7, NP-8, NP-9
- 5) Studimi dhe Përgatitja e Projekteve mbi Masat e Mbrojtjes nga Zjarrit të Ndërtesave te cdo lloji; Studimi dhe Projektim i Sistemeve Kundra Zjarrit;
- 6) Projektim objekte civile e turistike prej druri, projektim te instalimeve hidro- termosanitare, projektim rruge lokale, rruge urbane dytesore dhe rruge interurbane dytesore, projektim ura dhe vepra arti te vogla deri ne 10 m;
- 7) Investim, Sipermarrje, Ndertim, Montim, Rikonstruksion te objekteve e veprave te cdo lloji banimi, industrial, turistike, civile, objekte te karakterit publik & privat per punime te pergjithshme ndertimi NP-1, NP-2, NP-3, NP-4, NP-5, NP-6, NP-7, NP-8, NP-9
- 8) Hartim i Raporteve të Thelluara dhe Paraprake të Vlerësimit të Ndiqimit në Mjedis dhe përgatitja e të gjithë dokumentacionit të nevojshëm për aplikimet për procedurën të Thelluar dhe Paraprake të VNM-së per projekte te ndryshme mjedisore.
- 9) Pergatitja e dokumentacionit të nevojshëm për aplikimet për Leje Mjedis Tipi A dhe B për aktivitete të ndryshme mjedisore.
- 10) Mirembajtja e Lejeve Mjedisore dhe Hartimi i studimeve mjedisore te percaktuara ne kushtet e lejeve te mjedisit tipi A dhe B; Raporte Periodike të Vlerësimit të Ndiqimit në Mjedis; Planet e Menaxhimit të Mjedisit; Planet e Menaxhimit të Riskut; Raporte mbi Sigurinë në Punë; Planet e Përballimit të Emergjencave; etj.
- 11) Auditime Mjedisore; Ekspertiza Mjedisore; Konsulencë ne fushen e Mjedisit;
- 12) Auditime te Eficences se Energjise;
- 13) Hartim i Raporteve të Vlerësimit të Pasurive të Paluajtshme në prona me status Tokë truall + Ndërtesë.

## Neni 3

### Kohëzgjatja

- 1) Shoqëria do të ketë një kohëzgjatje të pakufizuar në kohë. Shoqëria mund të shpërbëhet në çdo kohë, ose të zgjasë periudhën e aktivitetit të saj, me vendim të ortakëve të shoqërisë.

V. Lajl

2

## Neni 4

### Selia

- 1) Selia e Shoqërisë "EVS Engineering" SH.P.K, ndodhet në adresën: Rruga "Saraçëve", Nd. 53, H. 1, 1017, Tiranë.
- 2) Ajo ka të drejtë të krijojë brenda dhe jashtë teritorit të Republikës së Shqipërisë filiale të Shoqërisë. Çdo ndryshim i selisë së shoqërisë do të bëhet me vendim të Ortakëve të Shoqërisë.

## Kreu 2 - Kapitali

## Neni 5

### Kapitali themelor

- 1) Kapitali themelor i shoqërisë është 10000 lekë (njëmijë lekë) = me dy (2) kuota, i derdhur dhe i shlyer tërësisht nga Ortakët e Shoqërisë.
- 2) Kuotat janë te shperndara ndermjet ortakeve si ne vijim:
  - a. Vanina Latifi zotëron 1 kuotë e cila përbën 50% të kapitalit dhe ka një vlerë nominale prej 5000 lekësh;
  - b. Egis Buzi zotëron 1 kuotë e cila përbën 50% të kapitalit dhe ka një vlerë nominale prej 5000 lekësh.
- 3) Për efekt të këtij Statuti, si kontribut i Ortakëve të Shoqërisë nijhet kontributi në para.
- 4) Kapitali i dhënë nga Ortakët Themelues është tërësisht dhe plotësisht i shlyeshëm dhe i nënshkrueshëm nga ana e tyre.

## Neni 6

### Zmadhimi dhe zvogëlimi i kapitalit

- 1) Kapitali i shoqërisë mund të zmadhohet me vendim të Ortakëve të Shoqërisë, përmes nënshkrimit të kontributeve në para.
- 2) Rritja e kapitalit themelor të shoqërisë nuk është e kufizuar.
- 3) Shoqëria mund të rrisë kapitalin themelor, ose mund ta zvogëlojë atë, por gjithnjë jo nën kufirin e 100.00 lekë-ve, sipas kërkesave të Ligjit nr. 9901, datë 14.04.2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare", i ndryshuar. Shtimi dhe paksimi i kapitalit bëhet me vendim të Ortakëve të Shoqërisë dhe sipas kërkesave të ligjit.

## Neni 7

### Transferimi i kapitalit

- 1) Kuota/t e kapitalit janë të transferueshme me pëlqimin me shkrim të Ortakut/ëve të tjerë të Shoqërisë. Transferimi i kuotës/ave të kapitalit bëhet vetëm me akt notarial. Pjesa/ët e kapitalit themelor janë plotësisht të transferueshme në rrugë ligjore, trashëgimnie, në rast ndarje pasurore ndërmjet bashkëshortëve, paraardhësve dhe pasardhësve.
- 2) Në rast vdekje të secilit prej Ortakëve të Shoqërisë, pjesa e kapitalit themelor që ai disponon i kalon trashëgimtarëve të tij. Trashëgimtarë hyn në shoqëri me të gjitha të drejtat e detyrimet përkatëse të ortakut. Në rast se asnjëri nga trashëgimtarët nuk pranon të punojë në shoqëri, athenë ata janë të detyruar të shesin pjesën e kuotave të kapitalit që trashëgojnë në favor të

Ortakëve të Shoqërisë. Pas shitjes së kuotave, trashëgimtarët marrin të gjitha fitimet qe iu takojnë sipas kontributit të derdhur në kapitalin themelor nga ortaku i vdekur.

- 3) Transferimi i kuotave të kapitalit bëhet sipas kërkesave të ligjit.

### Kreu 3 - Organet vendimarrëse dhe drejtuese

#### Neni 8

##### Organet e Shoqërisë

- 1) Organet drejtuese të shoqërisë janë:
  - I. Asambleja e Ortakëve e shoqërisë.
  - II. Administratori i shoqërisë.
- 2) Asambleja e Ortakëve është organi vendimarrës i shoqërisë.

#### Neni 9

##### Mbledhjet dhe mënyra e thirrjes së mbledhjeve

- 1) Asambleja e Përgjithshme mund të organizojë mbledhje të zakonshme dhe të jashtëzakonshme. Në të gjithë rastet, mbledhja mund të thirret nga secili prej ortakëve të Shoqërisë i cili do të jetë përgjegjës per njoftimin e datës, vendit dhe orës të mbledhjes si dhe të rendit të ditës shoqëruar nga materialet e nevojshme për tu shqyrtuar para mbledhjes nga ortaku/ët e tjerë.
- 2) Ortaku i cili thërret mbledhjen e Shoqërisë do të njoftojë Ortakët e Shoqërisë per vendin, datën dhe orën e mbledhjes jo më vonë se 30 ditë para datës së caktuar të mbledhjes. Rendi i dites dhe materialet shoqëruese do të njoftohen jo më vonë se 10 ditë para datës së mbledhjes. Për efekt të ketij Statuti, njoftimi me email do të njihet si formë e vlefshme njoftimi.
- 3) Mbledhjet e Asamblesë do të mund të mbahen vecse fizikisht, edhe përmes përdorimit të mjeteve të komunikimit elektronik (online).
- 4) Mbledhjet e zakonshme thirren të paktën dy herë në vit, pas mbylljes së vitit finansiar dhe kur aprovohet programi i veprimitarisë për vitin e ardhshëm.
- 5) Mbledhjet e zakonshme mund të thirren edhe kur secili prej ortakëve e quan të përshtatshme mbledhjen e ortakëve për të adresuar kërkesat e shoqërisë.
- 6) Secili prej Ortakëve të Shoqërisë merr pjesë në mbledhje personalisht dhe përfaqësimi me prokurë nuk lejohet.
- 7) Vendimet e Shoqërisë do të merren unanimisht.
- 8) Për të mbajtur procesverbalin e mbledhjeve caktohet një sekretar që mund të jete dhe një noter. Vendimet e Ortakëve të Shoqërisë duhet të nënshkruhen nga Administratori i shoqërisë, nga sekretari dhe nga Ortakët e Shoqërisë.

#### Neni 10

##### Administratori i Shoqërisë

- (1) Organi administrativ i shoqërisë është Administratori i shoqërisë. Administrator i shoqërisë “EVS Engineering” SH.P.K, për 5 vitet e para, do të jetë Znj. Vanina Latifi, lindur në Gramsh, më 01.03.1992 e banuase në Rrugën “Saraçëve”, Nd. 53, H. 1, Tiranë,



madhore, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, me kombësi e shtetësi shqiptare, mbajtëse e letërnjoftimit biometrik me nr. personal J25301112S.

- (2) Administratori ka një mandat 5 vjecar, përvèc rasteve të dorëheqjes së tij nga detyra e administratorit apo revokimit të tij nga detyra dhe emërimin e një administratori të ri me vendim të Ortakëve të Shoqërisë.
- (3) Administratori i shoqërisë përfaqëson Shoqërinë në marrëdhënie me subjekte të treta fizike ose juridike, publike ose private, vendase ose të huaja. Në këtë kuadër, Administratori mban dokumentacionin e Shoqërisë dhe siguron rregullsinë e tij dhe të mbledhjeve të Shoqërisë.
- (4) Administratori i Shoqërisë është mbajtësi i autorizuar i vulës së Shoqërisë.

## Neni 11

### Kompetencat e administratorit të Shoqërisë

- 1) Administratori i shoqërisë ka të drejtë dhe detyrohet të:
  - a) kryejë të gjitha veprimet e administritimit të veprimtarisë tregtare të shoqërisë, duke zbatuar politikat tregtare të vendosura nga Ortakët e Shoqërisë;
  - b) përfaqësojë shoqërinë tregtare;
  - c) kujdeset për mbajtjen e saktë e të rregullt të dokumentave dhe të librave kontabël të shoqërisë;
  - ç) përgatisë dhe nënshkruajë bilancin vjetor, bilancin e konsoliduar dhe raportin e ecurisë së veprimtarisë dhe, së bashku me propozimet për shpërndarjen e fitimeve, i paraqet këto dokumente përpëra Ortakëve të Shoqërisë për miratim;
  - d) krijojë një sistem paralajmërimi, brenda një afati të arsyeshëm, për rrëthanat, që kërcënojnë mbarëvajtjen e veprimtarisë dhe ekzistencën e shoqërisë;
  - dh) kryejë regjistimet dhe dërgojë të dhënrat e detyrueshme të shoqërisë, siç përcaktohet në ligjin për Qëndrën Kombtare të Biznesit;
  - e) raportojë para Ortakëve të Shoqërisë në lidhje me zbatimin e politikave tregtare dhe me realizimin e veprimeve të posaçme me rëndësi të veçantë për veprimtarinë e shoqërisë tregtare;
  - ë) kryejë detyra të tjera të përcaktuara në ligj dhe në Statut.
- 2) Administratori mund t'i delegojë të drejtat e veta një personi të tretë të autorizuar me shkrim për të përfaqësuar shoqërinë si edhe për të kryer veprime dhe praktika të ndryshme në emër të tij.

## Neni 12

### Asambleja e Ortakëve

- 1) Asambleja e Ortakëve përbëhet nga ortakët e Shoqërisë të cilët zotërojnë 100% të kapitalit të Shoqërisë.
- 2) Asambleja e Ortakëve është organi vendimarrës i shoqërisë dhe është përgjegjës për marrjen e vendimeve për shoqërinë për çështjet e mëposhtme:
  - a. përcaktimin e politikave tregetare të shoqërisë;
  - b. ndryshimet e statutit;
  - c. emërimin dhe shkarkimin e administratorit;
  - d. emërimin dhe shkarkimin e likuiduesve dhe të ekspertëve kontabël të autorizuar;



- e. përcaktimin e shpërblimeve për personat e përmenduar në shkronjat "c" dhe "d" të kësaj pike;
  - f. mbikqyrjen e zbatimit të politikave tregtare nga administratori, përfshirë përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
  - g. miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
  - h. zmadhimin dhe zvoglimin e kapitalit;
  - i. pjestimin e kuotave dhe anulimin e tyre;
  - j. riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë;
  - k. çështje të tjera të parashikuara nga ligji apo statuti.
- 3) Të gjitha vendimet e marra nga Ortakët e Shoqërisë regjistrohen në një regjistër vendimesh qe mbahet nga Administratori dhe të dhënët e të cilët nuk mund të ndryshohen ose të fshihen. Duhen regjistruar në veçanti, por pa u kufizuar në to, vendimet për:
- a. miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
  - b. shpërndarjen e fitimeve vjetore dhe mbulimin e humbjeve;
  - c. investime; dhe
  - d. vendimet për riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë.

#### **Kreu 4 - Viti dhe kontrolli finanziar i Shoqërisë**

##### **Neni 13**

###### **Viti finanziar**

- 1) Viti finanziar i Shoqërisë fillon në datë 1 Janar të cdo viti dhe përfundon në 31 Dhjetor, me përjashtim të vitit të parë ku si dëshëri për fillimin e vitit finanziar do të konsiderohet data e regjistrimit të shoqërisë.
- 2) Administratori ose personat e caktuar prej tij janë të detyruar të paraqesin bilancin vjetor dhe deklaratën e të ardhurave e t'i depozitojnë ato prane autoriteteve përkatëse.

##### **Neni 14**

###### **Fitimi i Shoqërisë**

- 1) Fitimi i realizuar nga ushtrimi i veprimtarisë ekonomike të shoqërisë do të administrohet nga Ortakët e Shoqërisë.
- 2) Një pjesë e këtij fitimi mund të përdoret për zgjerimin e aktivitetit tregtar. Shoqëria është e detyruar të shlyejë të gjitha detyrimet që ka ndaj shtetit dhe të tretëve.

##### **Neni 15**

###### **Kontrolli finanziar i Shoqërisë**

- 1) Kontrolli finanziar i shoqërisë kryhet nga një ose më shumë ekspertë kontabël të autorizuar ose të emëruar nga Ortakët e Shoqërisë me një afat prej tre vitesh financiare të njëpasnjëshme me mundësi riemërimi.

##### **Neni 16**

###### **Dokumentat financiare të Shoqërisë**

- 1) Llogaritë vjetore, inventarët, rapporti mbi operacionet e vitit finanziar dhe raportet e vecanta të hartuara nga administratorët apo ekspertët kontabël miratohet nga Ortakët e Shoqërisë.

Miratimi i dokumentave financiare vjetore bëhet brenda një afati 3-mujor, mbas datës së shlyerjes së vitit finanziar.

### Neni 17

#### Ndarja e fitimit të Shoqërisë

- 1) Mbas miratimit të llogarive vjetore dhe vërtetimit të ekzistencës së fitimit Ortakët e Shoqërisë, pasi kanë likuiduar të gjithë detyrimet ligjore financiare, vendosin për ndarjen e fitimeve.

### Kreu 5 - Marrëdhëniet e Shoqërisë

### Neni 18

#### Marrëdhëniet e punësimit brenda Shoqërisë

- 1) Marrëdhëniet e punësimit brenda shoqërisë rregullohen nëpërmjet kontratës së punësimit që lidhet midis palëve në përputhje me Ligjin nr. 7961, datë 12.07.1995 "Kodi i Punës i Republikës se Shqiperise", i ndryshuar.

### Neni 19

#### Marrëdhëniet kontraktore të Shoqërisë

- 1) Shoqëria mund të lidhë kontrata me sektorë shtetëror drejtpërdrejtë në tregun e lirë si dhe me persona juridik ose fizik, vendas ose të huaj.
- 2) Në veprimet kontraktore shoqëria përfaqësohet nga administratori i shoqërisë.
- 3) Të drejtat dhe detyrimet që rrjedhin nga kontratat janë të detyrueshme për shoqërinë.

### Kreu 6-Prishja dhe riorganizimi i Shoqërisë

### Neni 20

#### Prishja e Shoqërisë dhe emërimi i lukuiduesve

- 1) Shoqëria mund të prishet me vendim të Ortakëve të Shoqërisë ose kur ka shkaqe të tjera që cojnë në prishje të parakoshme të shoqërisë.
- 2) Shoqëria hyn në procesin e likuidimit që në momentin e prishjes së saj. Për kryerjen e këtij procesi emërohen një ose disa likuidator të cilët ndjekin operacionet e likuidimit deri në fund dhe i paraqesin Ortakëve të Shoqërisë rezultatet përfundimtare të likuidimit në përputhje me legjislacionin në fuqi.
- 3) Në perfundim të detyrës së tyre, Ortakët e Shoqërisë vendosin për heqjen e mandatit të likuiduesve.
- 4) Ortakët e Shoqërisë marrin përsipër për t'i shlyer të gjithë detyrimet që dalin nga akti i likuidimit me kapitalin e derdhur prej tij në kapitalin themelor të shoqërisë.

### Neni 21

#### Riorganizimi i Shoqërisë

- 1) Shoqëria mund të ndahet apo bashkohet, ose të ndryshojë formën sipas vendimit të Ortakëve të Shoqërisë, në përputhje me dispozitat e ligjit "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare", i ndryshuar.



## Kreu 7-Të tjera

### Neni 22

#### Zgjidhja e mosmarrëveshjeve

- 1) Të gjitha mosmarrëveshjet që nuk mund të zgjidhen me mirëkuptim ndërmjet ortakëve apo ndërmjet shoqërisë dhe të tretëve do të zgjidhen nëpërmjet Gjykatës kompetente të rrëthit gjyqesor.

### Neni 23

#### Legjislacioni i zbatueshëm

- 1) Cështje të tjera, të patrajuara në këtë statut do të trajtohen sipas legjislacionit shqiptar në fuqi, konkretisht sipas Ligjit nr. 9901, datë 14.04.2008 “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare”, i ndryshuar, Kodit Civil Shqiptar dhe akte të tjera ligjore dhe nënligjore të dala në zbatim të tyre.

### Neni 24

#### Vula e Shoqërisë

- 1) Shoqëria do të ketë vulën e saj e cila do të mbahet nga Administratori i Shoqërisë.

### Neni 25

#### Dispozita Finale

- 1) Statuti është hartuar me vullnetin e lirë dhe të plotë të Ortakëve Themelues dhe është nënshkruar prej tyre.
- 2) Statuti hartohet në katër kopje për t'iu shpërndarë organëve kompetente dhe ortakëve, si dhe një kopje mbetet në dokumentacionin bazë të shoqërisë.

Tiranë më: 10.10.2022

### ORTAKËT THEMELUES

Znj. Vanina LATIFI  
Vanina Latifi  
(emër, mbiemër, nënshkrimi)

Z. Egis BUZI  
Egis Buzi  
(emër, mbiemër, nënshkrimi)